



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-20025 /23

Klinë, dt: 16.06 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 10.05.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapì Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në dhe të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i propozimit të DKA-së për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre,
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin prill-maj 2023,
5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Më lejoni që të hap mbledhjen, duke ju kërkuar secilit për rend të ditës, nëse ka dikush, besoj që e keni marr rendin e ditës. Nëse s'ka, kush është për miratimin e rendit të ditës ?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi: Jemi të gjithë prezent, nuk ka mungesa!

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush rreth procesverbalit? Kush është për?

Me 7 vota PËR, pa asnjë vërejtje apo sugjerim, u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i propozimit të DKA-së për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju e dini që është një rutinë që përsëritet në ndarjen e bursave, ju e keni kërkesën, pastaj nëse ka të interesuar ja adresoni edhe faqes së kuvendit. Ne e kemi miratuar edhe rregulloren që e bën ndarjen e bursave të studentëve, neve na mbetet ta shqyrtojmë në KPF sepse ka implikime financiare edhe me rekomanduar pastaj për kuvend. Kuvendit i mbeten dy çështje kryesore sipas rregullores, rregullorja e lë në kompetencë të kuvendit numrin edhe sasinë, vlerën, në këtë rast ne kemi propozime prej DKA-së sipas mundësive buxhetore janë të dyja, po fjalën e fundit e merr kuvendi. Unë nuk po e zgjas më shumë sepse kërkesën e keni edhe ju, rregullorja është e miratuar, ne e kemi pasur njëherë debat edhe vitin e kaluar, jo me rritë, jo me zvogëluar, kjo puna e mundësive buxhetore, numri është ky që është i propozuar prej DKA-së, drejtimet me ato specifikat janë të përcaktuara me kritere gjithçka në rregullore, prandaj dy çështjet më të ndjeshme që janë vlera dhe shuma është diçka që mund të debatohet, nëse ka mundësi buxhetore lëvizet. Po, Asdren Ramadani?

Asdren Ramadani: Përshëndetje për të gjithë, unë desha të ndërlihem te kjo pika që është për bursa, për ndarjen me 50 euro, le të shikohet buxheti që nëse është mundësia bile të rritet, nga 50 të bëhet në 70. Arsyeja është që pak t'i dalim në ndihmë edhe studentëve tanë, për arsye se shumica prej tyre po i humbin shpresat në këtë vend, po shkojnë dhe po studiojnë jashtë. Duke e rishikuar buxhetin, pastaj nëse është mundësia nga 50 t'i rritet shuma në 70 euro, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Asdren, dikush tjetër? Po, Tunë, urdhëro?

Tunë Dedaj: Po kryesues, faleminderit, përshëndetje për të gjithë! Unë mendoj se kishte me qenë mirë edhe pajtohem me Asdrenin që të rritet kjo vlerë, të shkojë në 70 euro dhe më shumë nëse ka mundësi, po kisha pasur dëshirë, ky është mendim i imi drejtpërdrejt që me bërë një kontratë me ata studentë që financohen, që marrin bursë prej komunës, që ata me qenë të obliguar të punojnë në komunën e Klinës për nja dy-tri vite pasi ta kryejnë fakultetin. Ata që kanë mundësi për të punuar këtu, p.sh., mjekët, ka vende, ata po ikin krejt jashtë...

Fadil Gashi, Kryesues: Ndoshta duke e parë gjendjen reale me këtë koston e jetesës që po ballafaqohemi në këtë periudhë, ndoshta e ka arsyen, por ne mund të debatojmë gjithçka, ne propozimin e kemi, por kjo nuk dmth që as çmimet nuk janë si vitin e kaluar e si në këtë vit që janë, edhe ne kështu i kemi ndarë vitin e kaluar sepse në kritere nuk ma merr mendja se kemi nevojë, sepse kriteret janë të përcaktuara në rregullore dhe s'mund t'i shkelim askush, po unë po pajtohem nëse dominon propozimi i shumicës, ne me rekomanduar si KPF, nëse ju pajtoheni. A ka dikush tjetër? Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Dedaj: Të shqyrtohen gjitha mundësitë për mënyrën se si me rritë, është mirë bile kur ju ndihmon me pasur se çka me ju ndihmuar, se 50 euro me të vërtetë kjo ka qenë para 7-8 viteve kur është bërë edhe prapë është sot 50 euro, është shumë e vogël.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, urdhëro?

Asdren Berisha: Edhe arsyeja është që është bërë edhe shtrenjtimi i autobusëve për studentë p.sh., nuk është më shuma sa e kanë pasur biletën, si përpara.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush tjetër?

Tash e kemi ne një propozim, po më duket se po pajtoheni gjithë, te vlera prej 50 eurove të shkojë në 70 , rekomandim i KPF-së, prej krejt komunës në krejt buxhetin 11 milion a sa i bie..ndoshta 1200 euro me i shtuar po i bien. Atëherë nëse s'ka dikush, kush është për këtë komplet si pikë të rendit të ditës me rekomanduar po me këtë propozimin prej KPF-së, që KPF-ja propozon me 70 euro, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre, me 7 vota PËR, rekomandoi që të rritet vlera e bursave nga 50 euro në 70 euro në muaj, gjithashtu rekomandoi që kjo pikë të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin prill-maj 2023.

Kërkesë:

Nga banorët e fshatit Shtupel të cilët theksojnë: Në fshatin Shtupel, Komuna e Klinës, në lagjen "Bakaja", aktualisht është një rrugë me emrin "Fadil Zhabota".

Kjo rrugë është shumë e gjatë, duke filluar nga rruga kryesore Shtupel dhe përfundon në fshatin Jashanicë.

Fshati Shtupel dhe lagja "Bakaja" ka shumë persona që kanë sakrifikuar për komb, dhe shumë martirë.

Meqenëse kjo rrugë është shumë e gjatë dhe, pasi që kjo rrugë në lagjen "Bakaja" merr kthesë, banorët e kësaj lagje kërkojnë që pjesa e kësaj rruge të ndryshojë emrin dhe të emërohet rruga "Bajram (Bali) Arifaj".

Bajram Arifaj ka qenë banor i fshatit Shtupel, ka lindur me datë: 21.02.1929 dhe është vrarë nga forcat serbe, me datën 29.03.1999, i ndjeri ka punuar në Pejë dhe ka kontribuar në luftën e

Kosovës gjatë viteve 1997-1999, duke strehuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çka edhe është vrarë në vitin 1999.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju njoftoj se veç një kërkesë ka ardhur në drejtim të KPF-së edhe kjo nuk është në adresë krejt të saktë. Është kërkesë që ne duhet me rekomanduar, duhet me ja drejtuar komisionit, ne e kemi komisionin për emërtime të rrugëve dhe le ta shqyrtojë komisioni. Po më duket e kanë parë që e kemi bërë një emërtim në seancën e fundit edhe ai emërtim ka qenë ceremonial nuk është festiv, solemn është, ai nuk i nënshtrohet këtyre procedurave, një emërtim që e kemi bërë për një figurë në seancën e fundit, ndërsa kjo duhet me ju nënshtuar komisionit për emërtime. Unë po hap debat, a ka dikush për këtë kërkesë ose a po pajtoheni që kjo kërkesë të rekomandohet pa shkuar në kuvend, po drejt e në komision?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të rrugës, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e banorëve të fshatit Shtupel, të dërgohet për shqyrtim tek komisioni për emërimin dhe riemërimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës.

Pika 5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Në të ndryshme, nëse ka dikush? Sa për informatë, ne e kemi edhe një kalendar që e kemi miratuar, sipas kalendarit ne kemi pasur muajin qershor vizitë jashtë vendit. Definitivisht kanë rënë poshtë afatet procedurale për shkak të mungesës së mjeteve, po ka ndodhur defekti që unë edhe njëherë po jua them ju, ja kam thënë edhe ekzekutivit, mjetet planifikohen përmes Drejtorisë së Buxhetit, mjete që i planifikojmë ne. Nëse ju referohen buxhetit të përgjithshëm që ne e miratojmë në kuvend i kemi 5000 euro aty për shërbime edhe gjithnjë 2 000-3 000 euro na teprojnë, se ne jua shpërndajmë prapë drejtorive, po besoj se tash edhe kjo po na zhvendoset për pjesën e dytë të vitit, me rëndësi është me realizuar brenda vitit edhe mos me lënë pa e realizuar. Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Dedaj: Është mirë kur diçka e planifikojmë të realizohet ajo, kjo nuk është thjeshtë shëtitje, kjo është vizitë pune që e kemi paraparë me bërë jashtë vendit edhe është dashtë të gjenden mjetet edhe me realizuar, por, pasi është e pamundur tash në këtë kohë, propozoj që kjo të kryhet muajin shtator.

Fadil Gashi, Kryesues: Po patjetër, nuk kemi më alternativa se tash ne jemi keq me kohën, ne i bëjmë planifikimet tona ndërsa pjesën me mbuluar me buxhet duhet me bërë administrata, nuk e kemi ne, a ka dikush tjetër të ndryshmet?

Po besoj edhe me këto kompensime jemi rehatuar tash po më duket ne si komunë, e kemi telashe nga anëtarët e KPF-së te Komitetet për Komunitete, ata anëtarë që nuk janë anëtarë të kuvendit, ata s'po ka mënyrë si me i paguar, këtë telashe e kemi edhe dy tjera i kemi te Komisioni i Aksionarëve që është këtu, që e kemi themeluar ne, edhe duhet m'u trajtuar sipas rregullores që i trajton tash rregullorja e re për funksionet shtesë dhe Komitetin e Auditimit për

komunë të Klinës, unë po flas për do trupa që janë, nuk po flas për administratën, për punëtorët e komunës shërbyes civil po për këta trupa, këto tri defekte, problemin që ende nuk e kemi zgjidhur, pjesën tjetër më duket se e kemi mirë në Klinë, a ka dikush tjetër?

Tunë Dedaj: Drejtor, faleminderit shumë që ke ardhur këtu; një kërkesë njëherë më përpara, që nga trotuari t'i largoni shtyllat aty ku punohet, më ke thënë që e ke të paraparë në projekt edhe është mirë që t'i largoni sa më shpejt ato shtylla, se po i japin një pamje të keqe trotuarit, është kryer shumë mirë, por, shtylla mes trotuarit, s'po shkon ajo.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Përshëndetje kryesues, ju anëtarë të KPF-së, mysafirë! Është mirë m'u orientuar në cilin trotuar është fjala: a është trotuari për Zajm, trotuari për kah ura, trotuari nga hekurudha, tjetri atje kah Istogu, dmth në cilin?

Tunë Dedaj: Më vjen mirë shumë se janë duke punuar shumë trotuare dhe i falënderoj për punët që i kryeni, por çdo trotuar e ka pengesë, se janë shtyllat në trotuar.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Ajo është e planifikuar sipas inxhinierëve, ata janë profesionistë dhe ne kërkojmë ndihmën profesionale, kështu që, unë jam menaxher i projekteve dhe unë e marr mendimin profesional, besoj që përgjigja është profesionale!
Edhe unë i kam vërejtet e mija, por prapëseprapë duhet të bazohem në dokumente. Unë kam kërkuar që të bëhet një propozim i ri, me kusht që ana e majtë, ka të hysh në Klinë, të lirohet hapësira edhe tri metra, sepse ka hapësirë asfalti kah 8 metra anash, të lirohet me kusht që të krijohet një vijë e plotë të cilën nuk lejon makineri me u afruar afër shtyllave sepse edhe unë mendoj që makinat e rënda janë pak afër me shtyllat. Mirëpo, prapë se prapë, duhet të dijë se me hartë zonale është zonë urbane, po me zonë urbane është 30 maksimumi. Kështu që, duhet pasur kujdes, sepse në qoftë se shpejtësia zhvillohet e madhe, atëherë rrezikohen edhe qytetarët që të lëvizin lirshëm. Do të krijojmë rrugë alternative tjera me hyrë në Klinë, disa, se pajtohem me kryesuesin që kanë mundur me qenë në anën e kundërt, mirëpo ne e dimë se ato janë dy tekesh ose dy anësore, por ne i kemi marrë masat, jemi duke i parë, është më mirë sepse i vëren edhe dobësitë që janë në trotuar që janë në vazhdimësi, kam kërkuar që të lirohet të paktën edhe nja 30 cm, kurse trotuarin për Zajm e kemi vendosur në anën e kundërt, sepse është një kahësh, faleminderit!

Tunë Dedaj: Pasi dole aty, për mua, për syrin tim po them, janë të vendosur shkëlqyeshëm, nuk janë hiq keq të vendosura, se ngasësit e automjeteve janë të obliguar të shkojnë asfaltit e jo me dal në trotuar me prek, aty se prek askush, veç nëse e bën gabimin në komunikacion edhe është mirë se njëra anë e ndriçon trotuarin, tjetra anë e ndriçon rrugën. Mirëpo kur dole te zgjerimi i asfaltit, ti the me zgjeruar për 1 m, këshillë e imja ose në emër të qytetarëve po ta them, kërkesë e qytetarëve, e atyre votuesve që më kanë votuar mua është që ajo të shtohet edhe për 2 metra, se ka vend mjaft, janë 8 m rrugë shtetërore, plus 2m te trotuari tjetër. Kështu që, le të jetë hapësirë, kjo është kërkesë e qytetarëve, është toka, duhet me u shfrytëzuar toka për atë destinacion që e ka.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, faleminderit!


Enver Berisha, drejtor i DUMM: I nderuar, unë jam përditë duke u ballafaquar me këta, sepse

ata realisht kanë dëshirë që të investohet e të punohet trotuari por mbi gjitha këqyrin interesin personal, interesi personal mesa shihet pak ju ka zbehur, për shkak që kanë menduar që është një parking i gjithë bizneseve, në fakt ajo është trase e rrugës. Ne po kemi telashe të mëdha për t'u zbatuar projekti sepse kemi pengesa, ne duhet zakonisht të dialogojmë me ata, të bisedojmë, mos ta prishim interesin e mjedisit, por prapë se prapë, mbi të gjitha është i qytetarëve, dhe për atë po tregoj drejt se ka edhe indikacione që të shkohet edhe në mënyrë të njëjtë edhe në anën e kundërt, që mos të jetë më shumë pjesë e trasesë sepse ata mendojnë që traseja është në shërbim vetëm të bizneseve, po në fakt është edhe i qytetarit i cili do të lëviz i lirshëm, faleminderit!

Tunë Dedaj: Kërkoj falje drejtor, qytetarë nuk janë se qytetari është në interes të qytetarëve të përgjithshëm, jo atyre bizneseve që janë aty. Ata kanë për ta ditur që kanë ndërtuar objektet afër pronës shoqërore, dikush edhe e ka zënë pronën shoqërore, ti nuk mundesh tash me mbartë interesin e 4-5 lokaleve që i atakon dhe m'i dëmtuar, p.sh., qytetarët tjerë të komunës së Klinës. Është mirë rruga të zgjerohet edhe të zbatohet ligji, nuk je duke ja marrë atij pronën.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Tunë! Dikush tjetër? Nëse s'ka, atëherë unë e mbyll këtë seancë duke ju falënderuar për angazhim dhe pjesëmarrje!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

